

VALTER MEMISHA

FJALË DHE FRAZELOGJI NGA TRI VEPRA NË PROZË TË ISMAIL KADARESË

Studiuesi A. Vinca shprehet se “vepra e Kadaresë është e madhe si vëllim dhe e madhe si vlerë...; vepra e Kadaresë është e madhe me vëllim e saj dhe e madhe me kuptimin e saj...; vepra e Kadaresë është e madhe me pasurinë e saj ideore e tematike dhe e madhe me vlerën dhe bukurinë e saj artistike...; vepra e Kadaresë është kujtesë, etnos, botëkuptim dhe mendësi; ajo është emblemë e kulturës sonë kombëtare, me përmbajtje, domethënie e vlerë universale”¹. Vepra e këtij shkrimtari, si poezi e si prozë, si krijimtari letrare, si eseistikë, si publicistikë etj., zbulon dhe aftësinë e tij mjeshtërore në pasurimin e fjalorit të shqipes me njësi të reja, qofshin leksikore qofshin semantike. Ai mban kryet e vendit në këtë proces në shqipen e sotme. Dhe çka është më e rëndësishme pjesa dërrmuese e njësisve të krijuara prej tij përfshihen krejt nevojshëm e natyrshëm në leksikon normativ (së pari thjesht për vlerat shënuese e shprehëse që mbartin, por edhe për bukurfarkimin sipas gjedheve më vepruese e më prodhuese të shqipes së sotme).

Po japim disa grupe fjalëformimesh për të treguar këto vlera të shënuara:

a. Formime me prejardhje: *mbindjesi; arbëroj, baltëroj, diellëzj, krimbëroj; akullsirë, drithëtirë; gomarëri, gurëri, jetimëri, korbëri, lotëri, përrallëri, ngulmëri, pushtëri, qashtëri; syleshtësi, shpirtësi; flladitshëm, përhumbshëm, përvuajtshëm, nxitueshëm, trëndafilshëm, verbueshëm; mrekuallor, mbrapshtor; ankimtar, drekëtar; pikëtirë; vdekëron; fshehtan, shkallanë; fshehtinë, hekurinë, sipërani, shtrigani; shkretëtirëzim; gjithësor, imtësor; bornajë, pabesnajë, gjithkahnajë, llumnajë, plehnajë, qiellnajë, qyqnajë, vdeknejë, vjedhnajë, xunkthnajë, ylbernajë, yllnajë e dhjetëra të tjera*².

b. Formime me përbërje: *gojëcung, hënëzbardhur, gjysmëtrillan, kujtesëshkurtër; njeridashje syheqje, gojëkçje* etj. Do të veçoja një numër të madh formimesh me përbërje që mbartin semantikën e vepruesit (kompozita e ruan të qartë dhe të pavarur kuptimin kryesor të strukturës kuptimore të gjymtyrëve, duke mishëruar shumë funksionalisht ligjin e ekonomisë

¹ A. Vinca, *Fije të pakëputura (sprova letrare dhe kulturore)*, Tetovë, 2007, f. 299 -302.

² Shembujt ilustrues në këtë hyrje të shkurtër nuk janë dhënë sipas rendit alfabetik, por të grupuar sipas ndajshitesës me të cilën janë formuar. Nënndarjet i shënjon ; (pikëpresja).

gjuhësore): *baltëhedhës, bisedëvrasës, besëshkelës, buzëqeshës, dosjedashës, erashkëmbajtës, ëndërrçues, ëndrrandiellës, fajshlyes, fenerndezës, fenershues, grarrëmbyes, gjumëprishës, kombvrasës, kumtdërgues, kumthartues (lexo kumt-hartues), kumtsjellës, kumtzbërthyes, makthdërgues, makthparës, miqësiprishës, munxasprapsës, munxëdhënës, ndryshkaheqës, premtimshkelës, popullngrënës sfinafutës, vdekjethithës etj.*

c. Formime të përziera: *dallandyshtë (i), shkretëtirtë (i); dyjetshëm (i), jashtudhshëm (i), kuçedërshtëm (i), nënkafkshëm (i), merimangshëm (i) rrokaskajshëm (i), zezonshëm (i); dyjetësi, jashtëkohësi etj.*

d. Me paranyjëzim të pjesores: *humneruar (i) etj.*

Ismail Kadare e njuh nga afër strukturën e shqipes, ashtu si njuh nga afër dhe në brendësi aftësinë e mundësinë fjalëformuese të gjuhës së popullit. Duke u mbështetur në gjedhet e formimeve të fjalëve në gegërishte, ai krijon e hedh në përdorim shumë njësi që fitojnë menjëherë qytëtarinë e përdorimit. Po përmend këtu (krahas shumë njësive të përfshira më grupet e mësipërme) formimet me zanoret lidhëse **-a-** dhe **-o-**, si: *rrahagjoks, fortashtrojë, dehashpirt, ngazëllimotmerr etj.*

Ne po merremi me prurjet e reja që vinë në leksikon e shqipes nga vepra e Ismail Kadaresë, duke bërë vjelje leksikore në të gjithë korpusin e botuar deri tani (vjeljet janë bërë në botimet e Shtëpisë botuese “Onufri”). Duhet të theksojmë se njësitë e sjella nuk janë të gjitha nga Ismail Kadare, por ato janë njësi të reja përqsar me lëndën leksikore që është botuar në fjalorët shpjegues të shqipes deri më sot. Këto prurje leksikore nga vepra e Kadaresë do të shërbejnë si material për një fjalor të tipit të madh të gjuhës shqipe.

Më poshtë po sjellim 350 njësi (fjalë dhe frazeologji), të përzgjedhura nga grupi i njësive të vjela nga tri vepra të këtij autori, “Mosmarrëveshja”³, “Hamleti, princi i vështirë”⁴ dhe “Darka e gabuar”⁵.

Lënda e përzgjedhur përmban dhe disa emra veprimi që nuk janë dhënë si njësi brenda sistemit të tyre paradigmë fjalëformues (si një nga elementet e paradigmës), por që kanë vlera të spikatura shënuese e shprehëse. Në lëndën e vjelë nga këto tri vepra, nuk gjejmë foljet gjegjëse për këta emra. Duket sikur Kadareja ka bërë formime analogjike sipas gjedheve në sistemin e emrave të tjerë të veprimit. Mendoj se pavarësisht se cila është gjendja e këtyre njësive në përdorimin në veprat në fjalë, pontecialisht (*realisht*, për mua) këta emra kanë folje gjegjëse. Thjesht është një hapësirë boshe që gjuha e mbush menjëherë sa herë të jetë e nevojshme apo kur e kërkon akti i të folurit⁶. Kjo është arsyja se

³ I. Kadare, *Hamleti, princi i vështirë*, Shtëpia botuese “Onufri”, Tiranë, 2007.

⁴ I. Kadare, *po aty*.

⁵ I. Kadare, *po aty*.

⁶ Këtë e tregon dhe thjesht shembulli që po sjellim në vijim Në veprën eseistike “Mosmarrëveshja” kemi dy njësi nga një paradigmë e tillë, kemi emrin e veprimit

përse kemi dhënë *çlëndëzim* (por nuk kemi gjetur në këto vepra foljet *çlëndëz*, *çlëndëzohet*); *afganizim* (por nuk janë gjetur foljet *afganiz*, *afganizohet*); *zonjëzim* (por nuk janë gjetur *zonjëz*, *zonjëzohet*). Po kështu dhe *çngurosje*, *estetizim*, *haxhiqamilizim*, *hënëzim* etj. dhe jo foljet gjegjëse nga kanë ardhur / nga janë formuar ato.

Adhurimtar, -i m. sh. -ë(t) ai që adhuron dikë a diçka, adhures. *Kur T. S. Elioti shfaq mendimin, që ngjan befasues për një adhurimtar të Shekspirit, siç në të vërtetë ai qe, pra, kur Elioti thotë se "Hamleti" i kapërcente mundësitë e Shekspirit, me këtë ai donte, ndoshta, të thoshte se "Hamleti" kapërcente çdo mundësi.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 44)

Afganizim, -i em. m. sh. -e(t) veprimi sipas foljeve **afganizoj**, **afganizohet**; prirje për të mos u mbështetur të tiparet përbashkuese, unifikuese, identifikuese të një populli a kombi, por për t'u mbështetur në dallimet e ndarjet e tij tribale a krahinore. *Një prirje e cilësuar si "afganizim", ku vëmendja përqendrohej në grimcimin e historisë, zhveshjen nga aksionet dhe idetë e mëdha dhe zëvendësimin e tyre me përçarjet tribale ose dialektale, shfaqej shpesh si jehonë e racizmit të dikurshëm.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 185)

Akull, -i nj. fr. **Si e ngrirë në akull** mb. e konservuar, e ruajtur. *Njëra, e vjetër disa shekuj, por që vazhdonte ende, tjetra, e kryehershme, si e ngrirë në akull, që priste ndoshta kohën për t'u rizgjuar.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 138)

Antidiell, -i m. trup qiellor me veti të kundërta me ato të diellit. *Gjithë ajo bardhësi shtrojash, dantellash e perdes, që herë pas here, në vend të të mahniste, të ngjethte mishtë, kujtime incestesh e nuses, që e kishin humbur nderin, e pleqsh që jepnin shpirt nën një antidiell, në hajatat e mëdha, nuk shlyheshin lehtë nga kujtesa.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 43)

turqizim dhe mbiemrin prejpesor *turqizuar*, të cilat nënkuptojnë patjetër se në përdorim ekziston dhe folja *turqizoj*, nga ata janë krijuar:

Turqizim, -i m. veprimi sipas foljeve **turqizoj**, **turqizohem**. *Aleatja jonë do të vazhdonte jo vetëm turqizimin e shqiptarëve të Kosovës dhe Maqedonisë, por do të dëshironte shtrirjen e procesit në Shqipëri, me të njëjtin qëllim: defaktorizimin shqiptar, atë të cilin Ilia Grashanini i kishte rënë kambanës plot një shekull më parë. Vetëm e tillë, e turqizuar, pra thellësisht joevropiane, Shqipëria do të ishte përherë e dobët dhe e padashur prej Europës.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 28)

Turqizuar (i, e) mb. që është turqizuar. *Aleatja jonë do të vazhdonte jo vetëm turqizimin e shqiptarëve të Kosovës dhe Maqedonisë, por do të dëshironte shtrirjen e procesit në Shqipëri, me të njëjtin qëllim: defaktorizimin shqiptar, atë të cilin Ilia Grashanini i kishte rënë kambanës plot një shekull më parë. Vetëm e tillë, e turqizuar, pra thellësisht joevropiane, Shqipëria do të ishte përherë e dobët dhe e padashur prej Europës.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 28)

Antikrisht,-i *em.* ai që është kundër Jezu Krishtit, armiku i Krishtit, *fig.* armiku i njerëzimit. **Antikrishti** ishte i njohur, e megjithatë pyetjet për të vazhdonin ashtu si dy mijë vjet më parë. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 124)

Antiorom,-e *mb.* që është kundër romëve. *Lidhur me romët, shqiptarët nuk kanë qenë engjëj, rrjedhimisht ndajnë me popujt e tjerë europianë fajësinë e racizmit antirom.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 188)

Arm/ë,-a *nj. fr. armë e bardhë* *em.* armë e ftohtë. *Pas personazheve kryesore s'mungonin fantazmat e tyre dhe pas tyre, prapë gratë, disa herë me pamje fare të befasishme: gra me armë të zeza, ose gra me armë të bardha, por pa munguar asnjëherë femrat e mirëfillta, plot të fshehta e dyzime, thënë ndryshe gratë gra.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 161)

Arm/ë,-a *nj. fr. Armë e zezë* *mb.* armë zjarri. *Pas personazheve kryesore s'mungonin fantazmat e tyre dhe pas tyre, prapë gratë, disa herë me pamje fare të befasishme: gra me armë të zeza, ose gra me armë të bardha, por pa munguar asnjëherë femrat e mirëfillta, plot të fshehta e dyzime, thënë ndryshe gratë gra.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 161)

Aspaktë (i, e) *mb.* që nuk ekziston. *Në Jaltë, për shembull, më 1945, në ato minuta fatale, kur midis Stalinit dhe Çerçillit po këmbeheshin pusullat për ndarjen e Gadishullit Ballkanik, ne nuk e dimë çka kishte në trurin e tiranit sovjetik, në kohën që kemi të drejtë të mendojmë se lordi anglez, sipas frazës së lënë prej tij, do të donte ndoshta që historia të ishte sa më e paktë, për të mos thënë e aspaktë, pikërisht në këtë gadishull.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 192)

Atëmbretvrasës,-i *m. sh. -(it)* ai që vret të atin mbret. *Është mbreti atë, si dikur, dhe atëmbretvrasësi po ashtu, por të dy janë jashtë kohe dhe jashtë çdo logjike.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 141)

Bajronian,-e *mb.* që ka të bëjë me Bajronin a që i përket Bajronit, i Bajronit. *Duke perfrazuar Hajnen, që kishte folur për mundësinë e një këmbimi midis tij dhe Bajronit (e këmbimit të gëzimeve të tij me brengën bajroniane), mund të shpresohet se do të gjendeshin ndoshta ende shqiptarë që mund të jepnin gëzimet e tyre për një stinë pikëllimi të Kastriotit.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 200)

Ballo,-ja *nj. fr. Si në një ballo maskash* *ndajf.* duke ruajtur radhën e duke fshehur fytyrën. *Emrat e kontit Rutland, e lordit Southampton, e lordit Derby, e filozofit kryeministër Bacon, e të tjerë, renditen njëri pas tjetrit si në një ballo maskash, për të zënë vend prapa maskës prej bakri të një Uiliam Shekspiri, njëfarë "John of all Works" (që punon për tjetërkënd, çirak, zezak).* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 45-46)

Bashkëpadron,-i *m. sh. -ë(t)* ai që është padron bashkë me një tjetër a me të tjerë. *Shumë syresh, duke dëgjuar emra vezirësh e pashallarësh shqiptarë, kishin pasur iluzionin donkishotesk (më saktë, sançopançotesk) se ishin bërë vërtet bashkëpadronë të perandorisë së pafundme.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 60)

Besëprerës,-i *m. sh. -(it)* ai që të pret në besë. *Vuajtja e tyre kishte, gjithashtu, diçka danteske: një truall ndëshkimi, në trajtë kryeqyteti dhe grash, që zgjatin kryet nga dritaret: “ej, shok, ej zotni, drumepre, ngjitu në katin e pestë, rrethi i pestë, në apartamentin 18” (aty ku janë besëprerësit, drumepretë...).* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 147)

Besues,-e *mb.* që beson. *Dëshmia tjetër, ajo që jep Fantazma, me fjalë të tjera, dëshmia e vërtetë, ajo që e ka bërë të dalë nga varri, nuk është më pak besuese.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 33)

Bezdisës,-e *mb.* që të bezdis. *Kastrioti ishte bezdisës për ta, ashtu siç ishte i tillë për ndërgjegjen e rënduar të një pjese të Shqipërisë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 56)

Bish/ë,-a *nj. fr. Si një bishë e lidhur ndajf.* duke u përpëlitur me shumë forcë. *Mendja përfytyrohet shpesh si diçka që kërkon të dalë nga kafka, gati-gati si një bishë e lidhur, më së shumti qen, që rreket të shkallmojë vargonjtë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 66)

Bjerrë (i, e) *mb.* që është bjerrë. *Nëse do të donim ta vinim patjetër në një raport me botën, ajo do të ishte një model i historisë së bjerrë të njerëzimit.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 125); *Ka një gërshetim të pashpjegueshëm midis Amlethit mediokër të kronikës mesjetare dhe të Hamletit princ të teatrit shekspirian, të jetëshkrimit të bjerrë të vetë Uiliam Shekspirit, dhe të jetëshkrimit tjetër, atij luksozit, të fshehurit apo të humburit të tij.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 129)

Brerje,-a *f. sh. -(e)t* veprimi sipas foljes **brej**; gërryerje. *Gjithnjaja tërheqëse e psikanalizës, bota e ëndrrave, e halucinacioneve, e skutat e fshehta të shpirtit, brerja e ndërgjegjes e të tjera si këto, përpara se të shënjohej nga psikanaliza, janë zbuluar mijëra vite më parë pikërisht nga letërsia.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 92)

Bubullues,-e *mb.* që bubullon. *Megjithatë sado bubullues të dukej, ai nuk e pengoi dot fluturimin e një avioni që çonte në Xhedah dërgatën që do të fuste Shqipërinë në Lidhjen Islamike.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 29)

Bujtur,-i *m. sh. -(it)* ai që ka bujtur diku para një bujtësi tjetër. *Kishin qenë gjithfarësh, të hareshme e të lemerishme, me bujtës që; nga gëzimi, kishin dashur të hidheshin nga pullazi, të shtinin mbi njëri-tjetrin mu midis hareshë, të rrëmbenin zonjën e shtëpisë apo të gdhiheshin të helmuar në mëngjes, të gjithë bashkë, bujtës e të bujtur.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 23)

Burimsh/ëm (i), -me (e) *mb.* që është i brendshëm, në vetvete, për natyrë. *Historia nuk ka kurrfarë përparësie intrinseke (të burimshme) ndaj mitit, dhe as ky i fundit ndaj historisë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 98)

Burimshëm *ndajf.* nga ana burimore; në mënyrë intrinseke. *Ndonëse kjo intermexo rrok një kohë të kufizuar: dimrin midis dy viteve, 1943 dhe 1944, burimshëm, ajo lidhet me të vërteta të tjera, njëqind, dyqind, e madje gjashtëqindvjeçare.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 80)

Cezarian/e,-ia f. që lidhet me Cezarin. *Por nuk arritën, dhe atij po i mbetej tani pjesa më e volitshme e historisë së vjetër, cezariana, por pa mort.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 109)

Çarturi,-a f. çorientim, shpërbërje. *Pikërisht në shekullin XX, atëherë kur dija njerëzore u bë më e aftë, që, nëpërmjet analizës së dhëmbëve të një mumieje, të përcaktojë nëse faraoni mumiemadh ka ngrënë mjaltë, në mëngjesin e fundit të jetës së tij, në prag të vrasjes; në shekullin XX, pra, anketa për Hamletin hyri, përfundimisht, në mjegull e çarturi të plotë.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 47-48)

Çekuilibrues,-e mb. që të çekuilibron. *I ngjashëm me praninë e një vrimë të zezë, mijëra herë më çekuilibrues se fantazma e Elsinorit, mediokriteti zotëron një pushtet të pafund.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 137)

Çlëndëzim,-i m. sh. **-e(t)** fig. veprimi sipas foljeve **çlëndëztoj**, **çlëndëzohet**; humbje e lëndës, prishje, dematerializim. *Si për drejtpeshim të vdekjes kishte pasur mungesën e varrit thënë ndryshe: çlëndëzim.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 40); **Çlëndëzimi** që pësoi Gjergj Kastrioti ishte hapja e një programi rikthimi, po të përdorim gjuhën e sotme. Në shumicën e baladave arbëreshe për të, ndihej kjo frymë mjegullore. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 48)

Çmitiz/oj kal. **-ova, -uar** e bëj diçka të mos jetë më mit. *Ju kujtohen thirrjet: hidhini baltë, quajeni bukëshkalë, gjakmarrës, së fundi bëjeni joshqiptar, vllah ose serb... Shkurt: çmitizojeni!* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 68); *Por fjalët thuhën në të njëjtin vit, kur në Tiranë, në kryeqytetin shqiptar, vlon një polemikë e ashpër pikërisht për Skënderbeun, për mitet që kinse janë krijuar për të, e që duhen çmitizuar, pra, rrënuar me ngut.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 75)

Çmitizim,-i m. sh. **-e(t)** veprimi sipas foljeve **çmitizoj**, **çmitizohet**. ... gjithë çështjet madhore të kombit shqiptar, Rilindja, gjuha shqipe, zanafilla ilire e shqiptarëve, raportet e mitit me historinë, vetë **çmitizimi** dhe mitet e rrejshme shqiptare, do të ndërlikoheshin rreth tij. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 70); *Debati për mitet dhe çmitizimin që u zhvillua në Shqipëri, pas rënies së komunizmit, ka qenë një ndër më të padenjët për nga çoroditja e tij.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 97); *Ndonëse, sipas dokeve politike zvicerane, çmitizimin e Tell-it mund ta vendoste referendumi, nuk do të kalonte shumë kohë që një tjetër referendum të kërkonte rikthimin e heroit mitik, që nuk kishte jetuar kurrë, bashkë me shtatorët, baladat e tekstet shkollore që flisnin për të.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 184)

Çmitizues,-e mb. që çmitizon diçka a dikë. *Mendimi i mësipërm, i shprehur nga një bashkëkombës i personazhit, mund të merrej si vetëledhatim i sedrës kombëtariste, sidomos në mjediset çmitizuese.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 202)

Çmitizues,-i m. sh. **-(it)** ai që çmitizon. *Të mbrosh një komb nga shuarja e vet është, sipas shumë njerëzve, ndër motivet më të epërme në botë, por në*

Shqipëri, ka ca kohë që, prej **çmitizuesve**, kjo quhet “kombëtarizëm”, si të thuash një merak i kotë, shoqëruar me ironi, madje tallje. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 77)

Çngurosjë,-a f. sh. **-e(t)** edhe fig. veprimi sipas foljeve **çnguro**, **çnguroset**; prishja e gjendjes së ngurtë a të ngrirë të diçkaje. *Gjermanët e ngurosor, shtrirë të vdekur në sallon, dhe vajza e doktorit, që kujtonte se i kishte helmuar, dhe pastaj çngurosja njëri pas tjetrit, ringjallja si në pashkë, jo një, por e një skuadre krishtësh, lëre, ç’e kujton, s’ ishte vetëm turp, por turp e mëkat bashkë.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 49)

Çukitjë,-a nj. fr. **Çukitje pulash** em. dëm i vogël, dëm i papërfillshëm. *Ndryshimi ishte se ajo që po ndodhte nuk ishte një çukitje pulash, por një sqeptim skifterësh.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 106)

Darkëtar,-i m. sh. **-ë(t)** bujtës që darkon në një familje. *Qe kthyer pastaj në shtëpi, për t’i thënë t’et: e krewa porosinë, zoti tatë, në kohën që te dera që shfaqur i vdekuri me ftesën e darkës në dorë, duke tmerruar darkëtarët e të zotit e shtëpisë: më ftove, ja ku erdha, mos më vështro ashtu!* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 24); **Darkëtarët** vështronin njëri-tjetrin, pastaj sytë e të zotit të shtëpisë, si të kërkonin ndihmë se si të shmangej kjo bisedë. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 33)

Defter,-i nj. fr. **I fshirë nga defteri** mb. i humbur, i harruar. *Si të tillë, për kanunin e ashpër shqiptar, ata ishin të zhburrëruar për jetë, pra, të fshirë nga defteri i kësaj bote.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 146)

Dërgat/ë,-a f. sh. **-a(t)** grup të dërguarish diku për të përfaqësuar një grup njerëzish, një etni, një popull etj., për të mbrojtur dikë a diçka, delegacion. *Ishte përsëri Skënderbeu në bronz, i cili, ndonëse pa kalë dhe pa shpatë, pra, më pak madhështor e më pak kërcënues, qenkësh po aq i bezdisshëm për dërgatat e shtetit të sotëm turk, gjashtëqind vjet më pas.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 56); **Pikërisht** kur u duk se gjithçka po vihej në vijë, një raport i fshehtë i një dërgate edhe më të fshehtë nga kryeqyteti, kumtonte, e zezë mbi të bardhë, se rënia vazhdonte. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 72); *Si në katastrofë natyrore, nga kryeqyteti niseshin me ngut kamionë me ushqime dhe barna, inspektorë, orkestra e gjithfarë dërgatash, një pjesë nga vendet mike.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 71)

Dëshpërimisht ndajf. në mënyrë të dëshpëruar. **Dëshpërimisht** i bukuri. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 85); *U soll ky shembull, i ngjashëm ndoshta me fluturimet poetike të moshave të reja, për të riardhur te mendimi se çështja e kombeve edhe kur shfaqej në kostumin dëshpërimisht banal të ekologjisë, e kishte përherë dozën e “parimit shpirtëror”.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 170-171)

Diaspor/ë,-a f. sh. **-a(t)** grup etnik a popull që lë vendlindjen tradicionale dhe shpërndahet nëpër botë. *Madje dhe diaspora antikomuniste*

shqiptare ajo që përgjonte ditë e natë çdo braktisje dhe...(I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 14)

Diell,-i *nj. fr. Si dielli në dimër mb.* shumë i ftohtë. Ajo është rrezëllonjëse, e dhembshur, por e ftohtë, **si dielli në dimër**, që vjen nëpërmjet një pasqyre, e që nuk ngroh më. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 51)

Doktrinu (i, e) *mb.* që i është nënshtruar një presioni të vazhdueshëm ideologjik, i indoktrinu. *Shumica të rritur në familje të doktrinuara prej një fryme të skajshme komuniste, çmitizuesit e ardhshëm, në përplasjen e dy S-ve, duke qenë me Stalinin (bijtë e Stalinin jemi ne, siç e thoshte kënga), kishin qenë, pa qenë të ndërgjegjshëm ndoshta dhe vetë, kundër Skënderbeut.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 198)

Dramatikisht *ndajf.* në mënyrë dramatike. *Por më befasuese se pyetja mund të duket përgjigja: Kastrioti i shqiptarëve, jo vetëm s'fiton asgjë prej mitit, por humb, për të mos thënë, dramatikisht humb prej tij.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 143); *Zbardhja e ditës, atëherë kur pamja e gjërave shpesh ndryshonte dramatikisht, malet s'dukeshin më aq të larta sa ç'ishin përfytyruar, greminat jo aq të zeza dhe ëndrrat jo aq joshëse, shkurt, kur të vinte koha e zhgjëndrës kjo do të ishte edhe koha më e rrezikshme për apostujt.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 114)

Dritëzim,-i *m. sh. -e(t)* veprimi sipas foljes **dritëzon, dritëzohet**; dritësim, ndriçim. *Ndërkaq, ishte diçka që jo vetëm nuk zbehej, por, nën dritëzimin* zymtor të muzgut, merrte atë forcë kërcënuese, që veç tragjizmi e jepte. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 144)

Drithm/oj *kal. -ova, -uar* *fig.* bëj të dridhet dikush, rrëqeth. *Asnjë fjalë e tyre gjer në atë çast nuk e kishte drithmuar ashtu gjithë qenien e doktorit.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 91)

Drojtur *ndajf.* me droje. *Ky lloj incest i vërtitet dramës së "Hamletit", por drojtur, si të mos mbetej vend për të midis gjëmave të mëdha.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 66)

Drumepre,-ja *m. sh. -(të)* njeri që di vetëm të presë a të gatitë drutë për t'u djegur në sobë a në furrë; njeri i rëndomtë; njeri i pagdhendur, njeri i trashë. *Vuajtja e tyre kishte, gjithashtu, diçka danteske: një truall ndëshkimi, në trajtë kryeqyteti dhe grash, që zgjatën kryet nga dritaret: "ej, shok, ej zotni, drumepre, ngjitu në katin e pestë, rrethi i pestë, në apartamentin 18" (aty ku janë besëprerësit, drumepretë...).* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 147)

Dryn,-i *nj. fr. I mbyllur në dyzet dryna mb.* i burgosur, shumë i siguruar. *Ai shkak që, ndonëse i mbyllur në dyzet dryna, shkakton ende frikë dhe mort.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 93)

Dybridhish,-e *mb.* me dy brirë dhie. *Kthema Shqipërinë, qafir! Horr Europe, bukëshkalë e zuzar dybridhish, ulërinte sulltani.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 160)

Dybrirësh,-e *mb.* që ka formën e dy brirëve a që përbëhet nga dy brirë. *Pak më poshtë biseda kthehet prapë tek Kastrioti, këtë herë tek pamja e tij. "Djall dybrirësh, thoshte kronisti, përpara se ta pyeste për pamjen. (I. Kadare, Mosmarrëveshja, f. 199)*

Dyesi,-a *f.* të qenët në dy forma. *Ai nis me një ëndërr të sulltanit, ku dyesia, siç u përmend më lart, shfaqet së pari si motiv kryesor. (I. Kadare, Mosmarrëveshja, f. 135)*

Dyfetariz/ëm,-mi *m.* gjendje ku bashkekzistojnë dy besime fetare. *Feja e njëjtë, për shembull, për një kohë të gjatë, ishte marrë si faktor që nxiste kombformimin, kurse, sipas një pikëshikimi më të thellë, ishte ndoshta dyfetarizmi, madje, trifetarizmi, si në rastin shqiptar, shtysa më e sigurt për të njëjtën gjë. (I. Kadare, Mosmarrëveshja, f. 169)*

Dyjetës,-i *m. sh. -(it)* ai që jeton dy jetë, tokësoren e jotokësoren. *Kryesorja është trajtimi i Shekspirit në mënyrë të epërme, si një dyjetës. (I. Kadare, Hamleti..., f. 140)*

Dyjetësi,-a *f.* të qenët me dy jetë. *Ka gjasë që ajo lidhet me trazimin më të vjetër të njeriut: ëndrrën për dyjetësi. (I. Kadare, Hamleti..., f. 129); Ajo është pjesë e qenies së tij, madje, gjer në atë shkallë saqë ai vetë qëllon që nuk e kap dot nëse kjo dyjetësi është një venom apo një barrë e rëndë për të. (I. Kadare, Hamleti..., f. 129)*

Dykreni,-a *f.* të qenët me dy kokë (me dy krena). *Hijen mbretërore ia jepte natyrshëm shkaba e zezë, kthetrat, e sidomos dykrenia e saj. (I. Kadare, Mosmarrëveshja, f. 10)*

Dytës-i *m. sh. -(it)* njeri që i ngjet aq shumë një tjetri, saqë mund ta marrim për të, sozi, dytëshor, kipc. *Por kjo nuk pengonte që pamja e tij të zhvendosej përjashta, nëpërmjet njeriut që e kishte atë detyrë: dytësit të tij. (I. Kadare, Mosmarrëveshja, f. 132)*

Edipian,-e *mb.* që ka të bëjë me Edipin a që i përket Edipit, i Edipit. *Ai, gjithashtu, është i mbërthyer nga kushtëzimi edipian, pavarësisht se vdekja nuk e lë të njëmendësohet. (I. Kadare, Hamleti..., f. 104)*

Eskilian,-e *mb.* që ka të bëjë me Eskilin a që i përket Eskilit, i Eskilit. *Jemi, as më shumë, as më pak, në kushtëzimin antik, atë që gjenia eskiliane e kishte ndier, por pa e njëmendësuar dot në art. (I. Kadare, Mosmarrëveshja, f. 56)*

Estetikisht *ndajf.* në mënyrë estetike. *Në teatrin e Prishtinës, në nëntorin e vitit 1999, pyetja u shtrua me ngut, me alarm, jo më estetikisht, por politikisht, madje, ushtarakisht, për të mos thënë policërisht. (I. Kadare, Hamleti..., f. 63)*

Estetizim,-i *m. sh. e(t)* veprimi sipas foljes **estetizoj**, **estetizohet**; veprimi për ta bërë diçka që të ketë lidhje me estetikën, që të ketë lidhje me të bukurën. *Ide të turbullta lajkatuese për energjinë barbare që ndryshonte brenda saj gjeninë për njeriun e egër, por fisnik, përziheshin me teza të një*

frojdizmi pesë groshë, me vegime të dekadentizmit rus të fillimshekullit XX, ku nuk fshihej adhurimi për skithët, të gjitha këto përfundonin në shkrirjen e sëmurë përpara krimin, thënë ndryshe, jo vetëm në pranimin, por **estetizimin** e tij. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 115); Shpallja, dhe jo vetëm ajo, por pranimi i saj, dhe jo vetëm pranimi, por **estetizimi**, për të mos thënë himnizimi i saj, ishte me të vërtetë një faqe e re, fatkeqësisht e errët në jetën e kombit, ajo që do të bënte të mundur daljen e politikanëve pa atdhe. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 167)

Ëndërrimisht ndajf. duke ëndërruar. **Ëndërrimisht** i pashpjegueshmi. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 85)

Fajkërkues,-e mb. që kërkon se kush e ka bërë një faj. *Ndërkohë, dalja në skenë e dy hetuesve e ndërpreu vrullin e fantazisë fajkërkuese.* (f. 84)

Fajshpërndarës,-e mb. që shpërndan një faj. *Ishin të gjithë në një mendje për këtë, madje, aq fort, saqë kur dikush e gjeti, më në fund, një shpjegim të ri të asaj që kishte ndodhur, një shpjegim lehtësues e fajshpërndarës si era, të gjithë u ndien të lehtësuar.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 18)

Fantazm/oj vetv. **-ova (u), -uar** e përfytyroj si fantazmë. *Mund të thuhej se, përpara se të njëmendësohej si Shqipëri, vendi shfaqej, më saktë fantazmohej, si përplasje pasionesh.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 127)

Fetariz/ëm,-mi em. zell i tepruar fetar. *Ajo nuk lidhej me fetarizmin, siç spekulohesh shpesh, por thjesht me përmasën e së pashpjegueshmes, e ndoshta të paarsyeshmes, siç ndodhte në dashuri.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 167)

Fill,-i nj. fr. **Pa fill e pa bosht** mb. pa kokë e pa këmbë; i rrëmujshëm, kaotik. *Pas vdekjes së Kyd-it në burg, Shekspiri ka vendosur, më në fund, të vërë rend në atë kronikë kaotike, pa fill e pa bosht.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 124)

Fjalimmbajtës,-i m. sh. **-(it)** ai që mban një fjalim. *Do të masakroheshin foshnja si në kohërat biblike, do të bombardoheshin qytetet prej NATO-s, do të shpërnguleshin popuj, dhe vetë fjalimmbajtësi do të vdiste i vetmuar e me turp në një qeli burgu në Hagë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 130)

Flakëz,-a f. sh. **-a(t)** fig. diçka që sa ka filluar të krijohet. *Nëse shqiptarët do ta kapnin këtë në kohën e duhur, natyrshëm do të vinin tek e vërteta e qartë, që jo vetëm të mos lejonin askënd, por, të mos lejonin, në radhë të parë, veten e tyre që, me frymën e tyre, ta shuanin atë flakëz, për të cilën kishte bërë paralajmërimin himni i vjetër.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 173)

Fqinjërim,-i m. sh. **-e(t)** veprimi sipas foljeve **fqinjëroj, fqinjërohem**; veprimi për jetuar afër dikujt a për të qenë fqinj me të. *Ishte një prani, një fqinjërim i huaj, cenues dhe fyes, përbri të dyve, flamurit dhe himnit.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 12)

Frikës,-i m. sh. **-a(t)** frikacak. *I vetmi ndryshim ishte se në vend të "para partizan!" oficeri turk klith "pas meje, jeniçer!", klithmë pas së cilës trimat turq sulen kundër frikësave shqiptarë, atyre që më kot ishin rrekur t'i joshnin*

duke shtyrë gratë dhe vajzat shqiptare t'ua prishin mendjen azganëve me shallvare. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 180)

Frojdist,-e mb. që ka të bëjë me Frojdin a që i përket Frojdit, i Frojdit. *Shkaku merret me mend: ndër dy vrasësit e mëdhenj bazikë, njërit të nënës, tjetrit të artit, parapëlqehet ky i fundit, ngaqë vetëm ky i shkon për shtat leximit frojdist.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 85)

Ftohtësisht ndajf. në mënyrë të ftohtë. *Përpara se të përgjigjej e përqafoi Gurameton, por këtë herë ftohtësisht.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 31)

Fundbark,-u m. organi seksual i një femre. *Mund të merrej si këngë e përdhunuesve, që, të lidhur me pranga në "Guvën e Shanishasë", birucën që vëllai hakmarrës kishte sajuar më pas enkas për ta, e po aq mund të merrej për pjesën fatale të trupit të gruas, fundbarkun e saj, ai që i kishte çuar në tundim.*

Fundbotsh/ëm (i), -me (e) mb. që ka të bëjë me fundin e botës. *Vetëm përfytyrimi i bregut tjetër të Adriatikut, si bregdet osman, pra, robëri dhe pas robërisë përsëri robëri, do të ishte i fundbotshëm.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 44)

Fundekrejet ndajf. krejtësisht, tërësisht. *As më dysh, as më katërsh, as më tetësh, por fundekrejet duhej shpërbërë Shqipëria.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 27)

Gabues,-e mb. që gabon, që mashtron. *Do të duhej të mbërrinte shekulli XX, që njerëzimi të kapte se tmerrri i apokalipsit ishte shfaqur në të vërtetë, në pamjen e tij më gabuese, pas shprehjes "mbrojtje e mjedisit".* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 170); *Ishin këto maska gabuese, pengesa kryesore që shqiptarët të mos kuptonin dot se çka ishte në voli të tyre e çka ishte e kundërta.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 65); *Shkurt, pamjet që shtetet e botës dërgonin gjithkund me anë të postës, ishin veçse maska gabuese.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 8)

Gamil/e,-ja nj. fr. Gamile plakë em. Grua e moshuar e shëmtuar. *S'paskësh qenë kaq mizore sa ç'e dinim kjo gamile plakë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 64)

Goditsh/ëm (i), -me (e) mb. që mund të goditet, të cenohet. *Ashtu si tek krijesat antike, të përfytyruara shpesh si gërshetim i anës qiellore dhe asaj tokësore, ishte kjo e fundit më e goditshmja, ashtu edhe te Kastrioti kishte gjasë që përmasa historike e tij të ishte më e cenueshmja.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 102)

Grop/ë,-a nj. fr. Arrin fundin e gropës dikush fol. prek fundin. ... për të arritur fundin e gropës, atje ku dergjet tashmë modeli i tij, vëllai i madh Edip, pas të cilit, sipas Starobinski-t s'ka më fund. (I. Kadare, *Hamleti...* f. 88-89)

Grarrëmbyes,-i m. sh. -(it) ai që rrëmben gra. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, *Në katundet e Lunxhërisë herë pas here zhdukeshin vajza ose nuse të reja. I kërkonin gjithkund, te përroi, te gremina, te stanet e barinjve, gjersa kohë më pas, një pëshpërimë e lehtë si shushurimë mëndafshi ngulte këmbë se*

ato kishin përfunduar brenda shtëpive të larta të qytetit.) *Ishte apo s' ishte grarrëmbyes ky qytet, kjo nuk qe vërtetuar kurrë.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 13)

Grykësisht ndajf. fig. pangopësisht. *Mbi këto të fundit, më grykësisht se hulumtuesit mbi pergamenat e moçme, do të ngulen detraktorët.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 136)

Gufmuar (i, e) mb. që është gufmuar, që është fryrë. *Sagat veriore dhe ato islandeze e keltike, që, pasi kanë zbritur bashkë me vikingët nëpër Evropën Qendrore e gjer në Ballkan, janë ngjitur përsëri drejt veriut, të pasuruara e të gufmuara prej xixave të gjenisë a të marrëzisë së këndejme, nëpër rrugëtimin që e dinë vetëm epet e moçme* (I. Kadare, *Hamleti...* f. 65)

Gur,-i nj. fr. **Guri i varrit** em. shenjë se ka ekzistuar diçka a dikush. *Me sa duket, për gati dy mijëvjeçarë, fantazma e ka ruajtur trajtën e saj dyshe, një përzjerje e së rrokshmes me të parrokshmen, që vjen, me sa duket, nga zanafilla e saj, që, sipas Jean Paul Vernant, ka qenë guri i varrit.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 128)

Guran/ë,-a f. sh. **-a(t)** rrënoja muresh me gurë; grumbuj gurësh. *Qyteti, ndonëse kishte raste kur i ngjante një gurane të verbër, vinte re gjithçka.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 12)

Gjakftohtësisht ndajf. me gjakftohtësi. *Pas paroksizmit të pashoq, në sallën e teatrit të Prishtinës, më 1999, t'i kthehemi gjakftohtësisht kronikës së gjatë të dyshimeve, që nuk iu ndanë kurrë dramës së princit që kërkon gjakun e t'et.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 31); *Duke u ndeshur herë gjakftohtësisht e, më së shumti, me zjarrmi, njerëzit u ndanë, ashtu siç pritej, në dy palë: ata që e përligjinin pavendosmërinë e Hamletit me natyrën e tij të fisme, pra, të paafte për vepra gjakatare, të tjerët, që nuk mendonin ashtu.* (I. Kadare, *Hamleti...* f. 31)

Gjarp/ër,-ri nj. fr. **Si gjarpri në dimër** ndajf. duke rënë në gjumë letargjik. *Ato ngathtësohen, përgjumen, duket sikur kanë ngrirë si gjarpërinjtë në dimër, megjithatë janë përherë aty.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 34)

Gjarp/ër,-ri nj. fr. **Vezë gjarpri** em. diçka që mbart vdekjen apo pabesinë në embrion. *Iu kujtuan mohësave prejardhjen nomenklaturore, duke mos harruar t'i krahasonin me vezë të gjarprit, që donin të mbronin krimet e etërve të tyre, gjë që nuk u prit mirë prej opinionit publik.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 76); *Gjithmonë sipas tyre, vezët e gjarprit ishin kudo: në parlament, në qeveri, në media, në buzëqeshje të lodhura apo thinja, që zgjonin mëshirë, ose, në të kundërtën, në djem e vajza të reja, që vinin shpesh gjithë energji moderne nga Perëndimi, por që qysh çastin e parë kur maska u binte, shfaqeshin me një fytyrë tjetër.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 180)

Gjithëbotëror,-e mb. që ka shtrirje në gjithë botën, që i përket gjithë botës. *Ajo që cilësohet si "gjuhë e drunjtë", "e tharë", ose "burokratike" është tipar gjithëbotëror, që më shumë ka lidhje me stilin dhe varfërinë e të shprehurit se sa me vetë makinën gjuhësore.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 187)

Gjithëgjendsh/ëm (i), -me (e) mb. i kudogjendshëm. Në mes të ditës, i **gjithëgjendshëm** kudo: te kroi i katundit, në tryezë të bukës, në sytë e vajzave, te mulliri, te portë e kishës... (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 82)

Gjithkundshm/e,-ja f. em. ajo që gjendet gjithandej, që gjendet kudo. *Historia e përkthimit në Ballkan, qoftë ajo e përkthyesve gojorë, qoftë ajo e librave, ishte e ndryshme nga e gjithkundshmja.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 108)

Gjithnaj/ë,-a f. bota, gjithçka përreth nesh, universi. *Krahas kësaj ndihej, megjithatë, njëfarë mirënjohjeje ndaj fatit, që i kishte ruajtur nga gjëma të tjera, të harruara qyshkur, siç ishte Dynetshi, njëfarë përbindëshi kalendarik, që i shpëtonte përfytyrimit, një copë kohe e pangjashme me asgjë, ardhur s'dihej nga, prej thellësive të gjithnajës ndoshta, një ngjitje prej dy netësh, që ishin bërë njësh, pasi e kishin mbytur midis tyre ditën, siç mbytej gruaja që humbte nderin në shtëpitë e vjetra gjirokastrite.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 19); **Gjithnaja** komuniste vazhdonte të ishte në ethe. (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 87); **Kalimi nga gjithnaja** e pullave të postës te flamuri, përkonte pak a shumë me lamtumirën ndaj një vizioni disi planetar të botës, shenjat zotëruese të së cilës ishin kryesisht princesha, apostujt, lugetërit, shtizat, ujqit e kthetrat, të një vëmendje më shumë kombëtariste, ku shquheshin shpatat, gjermanët, Skënderbeu, grekët fqinjë e gjithë të tjerët. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 8); **Shfaqja e "Hamletit"** ndodhej përsëri, ashtu si përherë, në **gjithnajën** e vet: pyetje, polemika, dyshime pa fund. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 27); Në fund të fundit, krejt **gjithnaja** e letërsisë dhe e arteve është fqinjë me këtë botë (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 89)

Gju,-ri, nj. fr. E vë dikë në gjunjë fol. e gjunjëzoi dikë. *Dhe jo vetëm të mbrohej, por edhe t'i vinte në gjunjë të dy!* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 17)

Gjysmëgjak,-u m. etnog. gjak i pamarrë ndaj dikujt që nuk e ka vrarë, por e ka plagosur dikë. *Po le të kthehemi te fati i atentatorit, atij që i kishte borxh mbretit një gjysmëgjak.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 116); *Historia midis mbretit Zog dhe nënshtetasit të vet për një gjysmëgjaku nuk ishte veç njëra ndër qindra ngjarjet, që dëshmonin ngadhënjimin e kodit zakonor, më saktë, anës teatrore të tij, mbi gjithçka tjetër, madje edhe mbi atë që ishte më vështirë për t'u mposhtur, zemërimin mbretëror.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 78)

Hamendësim,-i m. sh. -e(t) veprimi dhe gjendja sipas foljeve **hamendësoj, hamendësohet**; veprimi për të nxjerrë një përfundim a një vlerësim në mënyrë të përafërt dhe jo sipas të dhënave të sigurta e të mjaftueshme. *E vërteta është se një hamendësim i tillë nuk është shtruar e as mund të shtrohej seriozisht për një personazh që, ndonëse u bë popullor në jetën artistike, kryesisht në atë teatrale, tepër e gjallë në atë kohë në Spanjë, mbeti në radhë të parë personazh i shout, po të përdorim një fjalë të kohës sonë, dhe jo i trillimeve të mëdha letrare.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 202)

Hamendësuar (i, e) mb. që hamendësohet. *Ai do të mbetej i tillë edhe në rastin e shmangies së fakteve e të zëvendësimit të tyre prej të dhënash më*

luksoze, si të thuash “të epërme”, si enigma e “black Lady-t”, e zbërthimit të soneteve e, padyshim, e marrëdhënieve të **hamendësuar** të poetit me lordin Southampton. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 130)

Hamendësues, -i m. sh. -(it) ai që hamendëson. Përpara se të rendin pas tyre, **hamendësuesit** i turren edhe njëherë të zotit të punës, Shekspirit. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 58)

Hamletian, -e mb. që ka të bëjë me Hamletin a që i përket Hamletit (personazhi kryesor i tragjedisë “Hamleti” të U. Shkspirit), i Hamletit. Me fjalë të tjera, edhe në rastin kur autori është një qenie **hamletiane**, pas çhamletizimit të tij (domethënë pasi të shkruajë “Hamletin”), ai pushon së qeni Hamlet. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 59)

Hamletian, -i m. sh. -ë(t) ai që është hamletian. A ka **hamletianë**? (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 62)

Hamletiz/ëm, -mi m. doktrinë që ngrihet mbi konceptin hakmarrës sipas atij që ka në qendër tragjedia “Hamleti” e U. Shekspirit. Ka gjasë që ambasadori i mbretërisë në Uashington, Faik Konica, pikërisht ai që kishte fshikulluar zakonin parak të kalimit të gruas nga vëllai i vdekur tek i gjalli, që kishte famën e njeriut më të dijsëm të Shqipërisë e që e njihte më mirë se kushdo Hamletin e **hamletizmin**, ngaqë, veç të tjerash, si maniako-depresiv që ishte, po t’i besojmë Apollinaire-it, druhej të vinte për vizitë në Shqipëri, nga frika se mos mbreti e helmonte. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 26); Më 1938, kur Cyrus Sulzberger pikasi **hamletizmin** në Shqipëri, së pari në pallatin mbretëror e pastaj në rrugët e vendit, nga mënyra si i ka përshkruar një pjesë të banorëve, “biondë, të hollë e të bukur, si të dalë drejt e nga Dhoma e lordëve” (frazja që do t’i miklonin aq fort racistët shqiptarë, të cilët ia kishin mbushur mendjen vetes se ishin më trimat dhe më të hijshmit e botës), nga kjo mënyrë, pra, kuptohet qartë joshja e gazetarit prej vendësve. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 70)

Haxhiqamilas, -i m. sh. -i(t) ai që përkrahte, mbështeste apo ndiqte nga pas Haxhi Qamilin. Ende pa u zbritur nga trekëmbëshat për t’u varrosur nën dhë, **haxhiqamilasit** ua kishin bërë një të keqe të atypëratyshme Shqipërisë dhe shqiptarëve. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 25)

Haxhiqamilizim, -i m. veprimi dhe rrjedhimi sipas foljeve **haxhiqamilizoj**, **haxhiqamilizohet**; prirja për të vepruar si Haxhi Qamili dhe haxhiqamilasit, duke u përpjekur të ndryshohen ligjet dhe rrjedhat normale të zhvillimit; të qenët kundër rrjedhës. *Shqipëria arrinte ta vinte në gjunjë haxhiqamilizimin.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 24)

Heleniz/ohet vetv. -ova (u), -uar bëhet helen. “Ka ardhur koha që Italia, krejt Europa të serbizohet, ashtu siç **u helenizuan** romakët pas pushtimit të Greqisë.” (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 116)

Heshtim, -i m. sh. -e(t) veprimi sipas foljes **heshtoj**; heshtje. Ajo ndodh në mjegull e në **heshtim** të plotë, gjersa Fantazma vjen të na e kumtojë. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 18)

Hënëzim,-i *m. sh. -e(t)* edhe *fig.* veprimi sipas foljeve **hënëzoi**, **hënëzohet**; ndriçim hënor. *Sipas tij, brenda shtëpive të mëdha, të ndërhuara, pa dyshim, nga mjeshtër të çmendur, nën qiellzanët trillane, përbri qelqeve të pamëshirshme të dritareve, ndodhte ai zhdrivillim a proces misterioz, njëfarë ikjeje në larginë a një hënëzim, shenjat e para të “zonjzimit”.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 75)

Himnor,-e *mb.* që ka të bëjë me himnin. *Një përdezje e tillë e mendimit vështirë të jetë dëshmuar në ndonjërin nga procesverbalet e mbledhjeve të poetëve “himnorë” siç i quajti dikush me shpoti procesverbalet e jurisë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 18)

Himnor/e,-ja *f.* ajo që ka të bëjë me himnin. *Himnet antike, kristiane, orfike, hebraike, Te Deum laudamus, kompozuar nga një shqiptar! (brr...), himnorja kombëtare, shqiptarocentrizmi, afrimi i njeriut me Zotin, kombin, ose lirinë, madje një himn i robërisë (brr...), himni Olimpik (lojtur në ditëlindjen e Hitlerit, brr...) himnet mbikombëtare, himni i Europës, fjalë të Shilerit, muzika e Bethovenit (503 vota, 96 kundër, 15 abstenim).* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 18)

Hirnos/et *vetv. - (u), -ur* edhe *fig.* merr ngjyrën e hirit, mjegullohet, humbet tiparet. *Por gdhinte mëngjesi tjetër, gjithçka hirnosej e vjetrohej dhe mendimi se nëse kishte diçka që nuk rinohej në këtë botë, ishte pikërisht koha, zotëronte përsëri.* (f. 65)

Hirnosj/e,-a *f.* edhe *fig.* veprim dhe rrjedhoja sipas foljeve **hirnos**, **hirnoset**; veprimi për të bërë diçka ngjyrë hiri. *Vargori i pafund i makinave vazhdoi gjatë gjithë natës në rrugën automobilistike. Mëngjesi dukej gjysmak për shkak të hirnoses.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 59)

Hovëz/oj *kal. -ova, -uar* i jap hov diçkaje. *Të gjitha këto e kanë hovëzuar, pa dyshim, hamendjen e zanafillës ilire dyfishe, gjuhë dhe popull, të shqiptarëve, por ishte një tjetër faktor, që i dha asaj shtysën përfundimtare për ta nxjerrë nga ligjërimi akademik e për ta zhvendosur në një botë krejtësisht të huaj për të.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 117)

Humbshëm *ndajf.* duke humbur vetëdijen, duke rënë brenda kokë e këmbë e duke harruar çdo gjë rreth e rrotull. *Kanë rënë në dashuri me të njëri pas tjetrit, humbshëm, siç u ndodh njerëzve të lodhur nga lufta.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 45)

Humnershëm *ndajf.* në mënyrë të humnershme. *Gjithnjë komuniste vazhdonte të ishte në ethe. Urdhura, paralajmërimi, kumte të fshehta e përshkonin humnershëm.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 87)

Iksh/ëm (i), -me (e) *mb.* që të largohet, që nuk të drejtohet ty. *Sytë i kishin të ftohtë, të ikshëm, por më e ftohtë se sytë ishte britma e tyre.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 146)

Ilirian,-e mb. që ka të bëjë me Ilirinë a që i përket Ilirisë, ilir. *Ja historiani Sima Cirkoviç, këmbëngulte se teza iliriane e shqiptarëve kutërbonte racizëm.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 188)

Incest,-i m. sh. -e(t) aktivitet seksual midis anëtarëve të një familjeje, midis anëtarëve me lidhje të ngushtë gjaku apo dhe me lidhje birësuese. *Jo më pak të thella janë zanafillat e martesave incestioze e të vetë incestit, si te historia e famëkeqit Juda Iskariotit.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 65)

Incestioz,-e mb. që ka të bëjë me incestin a që i përket incestit. *Jo më pak të thella janë zanafillat e martesave incestioze e të vetë incestit, si te historia e famëkeqit Juda Iskariotit.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 65)

Intrinsek,-e mb. i brendshëm, që buron nga vetë natyra e sendit; i burimshëm. *Historia nuk ka kurrfarë përparësie intrinseke (të burimshme) ndaj mitit, dhe as ky i fundit ndaj historisë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 98)

Jashtëkohsh/ëm (i), -me (e) mb. që është jashtë kohës. *Ashtu siç nuk dihet se ç'rol ka luajtur ky letërkëmbim, që u mbajti aq shumë i fshehtë e që tingëllonte i jashtëkohshëm.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 116)

Jashtëzim,-i m. sh. -e(t) edhe fig. veprimi sipas foljeve **jashtëzoi, jashtëzohet**; nxjerrje jashtë e diçkaje, eksteriorizim. *Kjo dalje e dhembjes prej strehës së saj natyrale, që ishte familja a fisi, me fjalë të tjera, ky jashtëzim (eksteriorizim) i saj, i jepte atë përmasë publike që, herët a vonë, do ta çonte te teatri.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 76)

Jetë,-a nj. fr. Jeta e amëshuar em. përjetësia, jeta jotokësore. *Ndërkaq, këta të fundit, prej kohësh e kanë bërë një zbulim: jeta tokësore është i vetmi shteg nëpërmjet të cilit, e keqja, virusi a mikrobi, mund t'i kalojë jetës së amëshuar.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 136)

Kaotikisht ndajf. në mënyrë kaotike. *Shtjella e errët e saj, midis së cilës motivet dhe personazhet shfaqeshin kaotikisht, dhjetëra Edipë, Uliksë a Prometej, duzina Filoktetë, Agamemnonë, Ajaksë e Klitemnestra, të gjithë me nyjëtime e maska të ndryshueshme, mund të lajthitnin jo vetëm Greqinë, por krejt botën.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 20-21)

Karburant,-i em. fig. ushqim shpirtëror. *Liria e kërkon se s'bën këtë karburant të vjetër, dhe shqiptarët e dinë këtë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 70)

Kastriotian,-e mb. që ka të bëjë me Gjergj Kastriotin, që i përket Gjergj Kastriotin, i Gjergj Kastriotit. *Për pikëvështrimin kastriotian, të dyja aksionet, lirimi i Shqipërisë dhe mbrojtja e bregut europian ishin në harmoni të plotë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 43)

Këmbëngulshëm ndajf. me këmbëngulje. *Atij që më fort se gjithçka më këmbëngulshëm, më frikshëm, i largohen të gjithë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 93); *Në atdheun e sllavëve të jugut vazhdonte ndërkaq këmbëngulshëm përndezja antishqiptare.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 26); *Përveç Biblës është e vështirë të gjendet një tjetër libër që të jetë hulumtuar më*

shumë dhe më **këmbëngulshëm** se drama e princit që kërkon shpagim. (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 9)

Këmishënat/ë,-a f. sh. **-a(t)** këmishë nate, veshje gjumi në formën e këmishës. *Do të hidheshin, pra, në erë, shtëpitë prej guri, tapitë, treqind gjykatësit perandorakë, shtëpitë e zonjave dhe, pas tyre, vetë zonjat, me këmishënatat e mëndafshita dhe të fshehtat dhe byzylykët, që do të binin si breshër.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 14)

Këngëtim,-i m. sh. **-e(t)** mënyrë të kënduari. *Ka gjasë të ketë këngëtime më të moçme, por kjo nuk ndryshon asgjë në thelbin e çështjes: vonesën e minieposit shqiptar.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 139); *I dehur prej nofkës të gjykuar shpesh qesharake: babai i kombit serb, ky antihomer e mbylli, me sa dukej, rrugëtimin e tij në letërsi me një vaj e njëkohësisht mallkim, gjini e njohur në këngëtimin ballkanas, ku shkruante për shqiptarët se “kjo fundërrinë sociale, politike e morale e Ballkanit tribal e barbar, e merr për aleat Amerikën dhe Ballkanin Europian kundër popullit më demokratik, më të qytetëruar e më të emancipuar të Ballkanit, popullit serb”.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 123)

Kish/ë,-a nj. fr. **Mbaj kishën** fol. ruan, nuk ndryshon besimin e krishterë (për një të krishterë). *Jep kryqin, të marrësh grada dhe poste. Mbaj kryqin, jep gjuhën shqipe. Mbaj kishën, jep Kastriotin. Merr tituj, jep emrin shqiptar. Mbaj armën, jep kryqin.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 61)

Kokakëmbësh,-i m. sh. **-a(t)** diçka e përmbytur dhe e ngatërruar, ajo që e ka kokën nga të ketë këmbët. *Ky këmbim do të ishte, pa dyshim, më i mbrapshti kokakëmbësh në historinë e Shqipërisë, e ndoshta të Europës.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 114)

Kombformim,-i m. sh. **-e(t)** formimi i një kombi. *Feja e njëjtë, për shembull, për një kohë të gjatë, ishte marrë si faktor që nxiste kombformimin, kurse, sipas një pikëshikimi më të thellë, ishte ndoshta dyfetarizmi, madje, trifetarizmi, si në rastin shqiptar, shtysa më e sigurt për të njëjtën gjë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 169)

Konician,-e mb., që ka të bëjë me F. Konicën a që i përket F. Konicës, i F. Konicës. *Perandoria po shembet, nga do t'ia mbajnë shqiptarët. Kushtrimi alla konician, ndonëse i vjetër, për veshin tonë ka tingëlluar po aq familjar, sa çdo të tingëllonte në çdo kohë britma: anija po mbytet.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 168)

Kosovarisht/e,-ja f. e folmja e Kosovës. *Sipas rimohuesve kosovarë, shteti i ri shqiptar i Kosovës kishte nevojë të ngutshme për një shqipe tjetër, atë të vetën, që ndoshta mund të quhej “kosovariste”.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 112)

Kotni,-i f. sh. **-(të)** kotësi. *Te kjo e fundit vunë edhe një herë shpresën. Kot! Kastrioti, sipas tyre, kishte luftuar për një kotni të madhe.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 152)

Kreni,-a f. krenari. “Albanologët e rinj” shqiptarë, nën dehjen e këtij epizmi të rremë mustaqesh, e pranonin gati me lektisje ngadhënjimin e diktatorit. Sipas tyre, gjuha shqipe, e lajkatur gabimisht prej shqipfolësve, po paguante mëkatet e **krenisë** së tyre dhe të asaj vetë. (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 112); *Kështu, pa ndonjë shenjë turpi apo krenie, madje, pa e vënë re as shpërfilljen e qytetit u hodhën mbi makinat e tyre, me lëvizje të natyrshme, thua se nuk po bënin gjë tjetër, veçse po niseshin të kërkonin një tjetër truall për të bërë luftë a, ndoshta, thjesht për të vdekur.* (I. Kadare, *Darka e gabuar*, f. 59)

Kryekrejet ndajf. tërësisht. *Me fjalë të tjera, jo vetëm që Kosova, bashkë me varret, manastiret, katundet, dhimbjet e gjithçka tjetër të epërme, ishte kryekrejet serbe, por dhe vetë kryeheroi i shqiptarëve Gjergj Kastrioti Skënderbeu ishte i tillë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 73)

Kryengulth,-i m. fig. përmbyse, kokëposhtësi. *Për të kapur diçka më shumë nga ky kryengulth makabër, le të kthehemi prapë te nata e ftohtë e shkurtit të vitit 1944, në Ramicë të Vlorës.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 89); *Në historinë e gjatë të shqiptarëve, asnjëherë nuk është bërë e modës një kryengulth i tillë në trajtë doktrine.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 179)

Kryq,-i nj. fr. **Jap kryqin** fol. ndërroj besimin fetar nga i krishterë në mysliman. **Jep kryqin**, të marrësh grada dhe poste. *Mbaj kryqin, jep gjuhën shqipe. Mbaj kishën, jep Kastriotin. Merr tituj, jep emrin shqiptar. Mbaj armën, jep kryqin.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 61)

Kryq,-i nj. fr. **Mbaj kryqin** fol. ruan, nuk ndryshon besimin e krishterë (për një të krishterë). *Jep kryqin, të marrësh grada dhe poste. Mbaj kryqin, jep gjuhën shqipe. Mbaj kishën, jep Kastriotin. Merr tituj, jep emrin shqiptar. Mbaj armën, jep kryqin.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 61)

Kthet/ër,-ra nj. fr. **I tregon kthetrat dikujt** fol. e kërcënon dikë, i tregon dhëmbët. *Perandoria shemër osmane, jo vetëm ishte shfaqur, por haptas ia kishte treguar kthetrat dhe dhëmbët Europës.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 156)

Kundërdosje,-a f. sh. **-e(t)** një dosje me dokumente kundër atyre që janë në një dosje të dhënë. *Në qilarët e thellë të Beogradit gjendeshin ende të mbyllura dosje që do t’u prishnin gjumin pinjollëve të komunizmit. Ndaj ata do të bënin gjithçka për të krijuar kundërdosjet.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 183)

Kundëreuropian,-e mb. që është kundër Evropës. *Sipas një studimi të A. Xhaferrit, në themel të tij spikaste një ndjesi e qartë kundëreuropiane.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 115); *Veç një gjë nuk ndryshoi: kahu kundëreuropian i Shqipërisë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 28)

Kundërfis,-i m. sh. **-e(t)** fis që është kundër njerëzve të tjerë të afërt me të. *E kështu me radhë: e bëmë të njohur, të panjohur, të fisit, të kundërfisit, të kohës, të pakohës.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 143)

Kundërhimn,-i m. sh. **-e(t)** himn kundër një himni të dhënë. *Një kundërhimn i vërtetë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 19); *Kishte ardhur koha*

për *leximin satanik të himnit shqiptar. Koha e kundërhimnit.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 33)

Kundërkrishterë (i, e) mb. që është kundër të krishterëve. *Por edhe të tjerët, ata që besonin në pathyeshmërinë e shtetit, ishin në një mendje se Spanja, si njëfarë dekaneje e krishterimit europian, kishte për mision që më fort e më shenjtërisht se kushdo ta mbronte kontinentin nga sulmi i kundërkrishterë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 156)

Kundërlogjik/shëm (i), -me (e) mb. që është kundër logjikës së vlerësimit e të gjykimit të gjërave. *Ka qenë i kundërlogjikshëm për vetë faktin se më 1915, vetë Shqipëria i kishte shpëtuar një masakre ndëshkuese të udhëhequr prej Turgut Pashës, shestuar, ndoshta, si ajo kundër armenëve.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 191)

Kundërshqiptar,-e mb. që është kundër shqiptarëve e Shqipërisë. *Çmitizuesit, ndoshta do të kishin fat edhe këtë herë, sikur të ishin treguar më të kujdesshëm. E kjo mungesë kujdesi lidhej me racizmin kundërshqiptar, atij që, siç u përmend më lart, edhe në mos e përligjte krejt krekosjen e tepruar shqiptare, në njëfarë shkalle shërbente si rrethanë lehtësuese për të.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 121) *Racizmi kundërshqiptar ka qenë edhe mbetej më i padurueshmi në Europë, pas antisemitizmit.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 121)

Kundërshqiptariz/ëm,-mi m. të qenët kundër shqiptarizmit. *Asnjëherë nuk është bërë përpjekje që kundërshqiptarizmi të shpallet haptas si doktrinë gati kombëtare.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 78)

Kundërtiranik,-e mb. që është kundër tiranisë. *Dyfytyrësh, dykahësh, ai qëndron në fundajën e ideve kundërtiranike të barazisë, të demokracisë e të mëshirës njerëzore.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 137); *Më e çuditshmja është se as më pas, kur idetë kundërtiranike lulëzonin përherë e më fort, nuk u shfaq ndonjë prirje qortimi në këtë lëmë.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 100)

Kurrfartë (i, e) mb. që është tepër i vogël, i pallogaritshëm, i parëndësishëm. *Sepse është e lehtë, madje aspak e gabuar, të thuash se gjeniu, prandaj është i tillë, ngaqë prej një diçkaje të kurrfartë, një kokrrizë rëre, për shembull, të krijojë perlën.* (I. Kadare, *Hamleti...*, f. 12)

Kurnjëherë ndajf. asnjëherë. *Por kurnjëherë nuk është këndellur ideja se të prapambeturit janë rojat e kombit, kurse të ndriçuarit janë përqeshësit e tij.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 179)

Kutërb/oj kal. -ova, -uar fig. bie erë të keqe. *Ja historiani Sima Cirkoviç, këmbëngulte se teza iliriane e shqiptarëve kutërbonte racizëm.*

Legjendarizim,-i m. sh. -e(t) veprim sipas foljeve **legjendarizoj, legjendarizohet.** *Trupi i tij nuk ishte gjetur kurrë, dhe kjo mund të dukej si një përpjekje e parë serioze për legjendarizimin e tij.* (I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, f. 40)

Letërmarrës,-i m. sh. -(it) marrësi i një letre. *Sipas dëshmimeve, letra e sulltanit se do ta falte po të pendohej e të rikthehej në fenë myslimane, do të*

*kishte përgjigjen se **letërmarrësi**, domethënë Kastrioti, i bënte të njëjtën thirrje mbretit: të kthehej ai vetë në fenë e krishterë. (I. Kadare, Mosmarrëveshja, f. 137)*

Lobin/g,-gu m. sh. **-gje(t)** lobim. *Ka gjithmonë kundërshtime, **lobingje** të kundërt, smirë, diplomaci. (I. Kadare, Mosmarrëveshja, f. 52)*

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)